



Vëllimi 4, Numri 3

prill 2023

BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

BRENDA KËTIJ NUMRI

Lajme dhe informacione
kundër terrorizmit - 1

Peter Jongbloed merr detyrën e
OPDAT CT RLA për Bosnje-
Hercegovinën, Serbinë dhe
Malin e Zi - 2

Kosova dënon LHT-në e dytë
të riadhesuar në maj 2022 - 2

Danimarka dënon një grua nga
Bosnje-Hercegovina për
ndihmën e ofruar ISIS-it në Siri
- 2

Raportet e CTED: Vlerësimi i
mangësive në zbatimin e
dispozitave kyçe të Rezolutave
të Këshillit të Sigurimit kundër
financimit të terrorizmit - 3



Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial
(OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit*

Ju prezantojmë në këtë numër me Peter Jongbloed, Këshilltarin e ri Ligjor Rajonal kundër Terrorizmit të OPDAT me qendër jashtë Sarajevës. Duke zëvendësuar paraardhësin e tij, Tom Saunders, Peter do të ofrojë ekspertizën e tij të vlefshme për institucionet homologe të zbatimit të ligjit në Bosnje-Hercegovinë, në Malin e Zi dhe në Serbi. Ju njohim, gjithashtu, edhe me dënimet e fundit të një LHT-je në Kosovë, dhe të një gruaje të riadhesuar në Danimarkë. E mbyllim këtë numër me një analizë të disa gjetjeve kritike në raportet e fundit të Drejtorisë Ekzekutive të Komitetit Kundër Terrorizmit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (CTED) mbi disa çështje që lidhen me luftën kundër financimit të terrorizmit.

Joe Baldwin
Këshilltari Ligjor Rajonal
për Kundërterrorizmin në Ballkan
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA, Tiranë
BaldwinJR@state.gov

Bledar Bashanoviq
Specialist Ligjor
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA
Tiranë
BashanoviqB@state.gov

Peter Jongbloed
Këshilltari Ligjor Rajonal
për Kundërterrorizmin në Ballkan
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA, Sarajevë
JongbloedPS@state.gov

Jasenska Ferizoviq
Këshilltare Ligjore
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA
Sarajevë
FerizovicJ@state.gov

Peter Jongbloed merr detyrën e Këshilltarit Ligjor Kundër Terrorizmit i OPDAT për Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi

Kemi kënaqësinë të njoftojmë se më 17 mars, Peter S. Jongbloed filloi si Këshilltar Ligjor i Përhershëm për Anti-Terrorizmin në Bosnje-Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi.

Peter është një prokuror federal karriere nga Distrikti i Konektikatit, ku së fundmi ka shërbyer si Shef i Njësisë së Sigurisë Kombëtare dhe Kriminologji Kibernetik. Duke punuar ngushtë me partnerë të shumtë në fushën e zbatimit të ligjit, ai ka trajtuar një sërë çështjesh të sigurisë kombëtare, duke përfshirë edhe hetimet dhe ndjekjet penale të qytetarëve amerikanë që kërkonin të udhëtonin jashtë shtetit për të luftuar për ISIS-in dhe Al Kaedën. Gjithashtu, në lidhje me sigurinë kombëtare, duke punuar bashkë me forcat e rendit, ai ka marrë pjesë në hetimet dhe ndjekjen penale të personave që kanë kërcënuar të godasin zyrtarët gjyqësorë, zyrtarët e zgjedhur publikë, udhëheqësit etnikë dhe fetarë dhe objektet fetare. Peter ka punuar ngushtë dhe rregullisht me hetues financiarë lokalë, shtetërorë dhe federalë duke ndjekur rrjedhën e parave brenda dhe jashtë Shteteve të Bashkuara dhe së fundmi rrjedhën e monedhës dixhitale si kriptovaluta, me qëllim zbulimin e aktiviteteve kriminale, si mashtrimet dhe financimin e terrorizmit. Gjatë karrierës së tij, ai ka marrë pjesë me sukses në hetimet dhe ndjekjen penale të një larmie rastesh shantazhi në nivel federal, ku kanë qenë të përfshirë anëtarë dhe bashkëpunëtorë të Cosa Nostra-s të përfshirë në vrasje, huamarrje, zhvatje, lojëra të paligjshme fati dhe në mashtrime, si dhe anëtarë të bandave

lokale të rrugëve që merren me vrasjet dhe sulme me armë, me trafik droge dhe me vepra penale që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.

Peter ka shërbyer në një sërë postesh mbikëqyrëse në Prokurorinë e Konektikatit në SHBA, duke përfshirë edhe në pozicione si Asistent i Parë, Shef i Divizionit Kriminal dhe Shef i Kriminologji të Organizuar. Përpara se të bëhej Asistent Prokuror në vitin 1987, Peter ka shërbyer si nëpunës ligjor në Distriktin e Konektikatit për gjyqtarin e distriktit Alan H. Nevas. Peter është diplomuar nga Shkolla që tani njihet si Shkolla e Drejtësisë e Universitetit Quinipiac, ku ai ka qenë pjesë e studimeve juridike dhe Kolegjit Trinity në Hartford, Konektikat.

Kosova dënon LHT-në e dytë të riatdhesuar në maj 2022

Më 1 shkurt 2023, trupi gjyqësor i Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës shpalli fajtor të pandehurin Ylber Bela me akuzën e organizimit dhe pjesëmarrjes në organizata terroriste. I pandehuri u dënua me pesë vjet burg, duke filluar nga dita e riatdhesimit në Kosovë.

Bela (40 vjeç) u riatdhesua në maj të vitit të kaluar gjatë një aksioni të përbashkët riatdhesimi të zhvilluar nga Shqipëria dhe Kosova. Ai e pranoi fajësinë për akuzat e ngritura gjatë procesit të gjyqësorit. Bela e pranoi se kishte udhëtuar drejt Sirisë në vitin 2013 për t'iu bashkuar organizatave terroriste Jabhat al Nusra dhe ISIS.

Gjykata në vendimin e saj i konsideroi si rrethana rënduese nivelin e lartë të përfshirjes në aktivitetet terroriste të ISIS-it, gatishmërinë dhe qëllimin e tij për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të tilla, nivelin e rrezikut të lartë që paraqet për shoqërinë vepra penale e të pandehurit, që të gjitha të lidhura me synimin e ngjalljes së ndjenjës së pasigurisë dhe frikës me pjesëmarrjen në aktivitete terroriste kundër jetës, lirisë të njeriut dhe rendit juridik ndërkombëtar. Nga ana tjetër, gjykata konsideroi si faktorë lehtësues të dënimit pranimin e fajësisë, moshën e re të të pandehurit, bashkëpunimin me gjykatën dhe pendimin e tij.

Konkretisht, gjykata nuk e pranoi kërkesën e të pandehurit për të kërkuar njohjen e kohës gjatë që cilës ai ishte mbajtur i ndaluar nga Forcat Demokratike Siriane përpara dënimit me burg nga gjykata.

Burimi: Prokuroria Speciale e Kosovës

Danimarka dënon një grua nga Bosnje-Hercegovina ndihmën e ofruar ISIS-it në Siri

Më 28 shkurt, gjykata daneze e distriktit dënoi Elmina Aljic, një person me dy shtetësi, nga Bosnje-Hercegovina dhe Danimarka, me katër vjet burg për mbështetje të Shtetit Islamik. Gjykata gjithashtu ia hoqi Aljicit shtetësinë daneze, që do të thotë se ajo mund të deportohet në Bosnje-Hercegovinë pas vuajtjes së dënimit me burg.

Aljic kishte udhëtuar drejt Sirisë me familjen e saj në vitin 2015. Gjatë qëndrimit të saj në Siri, ajo kishte punuar si amvisë dhe në këtë mënyrë i kishte ofruar mbështetje organizatës terroriste. Në vitin 2021, ajo është riatdhesuar nga një prej kampeve siriane së bashku me tetë fëmijët e saj.

Dënimi dhe vendimi për heqjen e shtetësisë mund të ankimohen.

Burimet: [Gruaja danezo-bosnjake dënohet me katër vjet burg për ndihmën e ofruar Shtetit Islamik në Siri](#)
[Dansk-bosnisk kvinde udvises for husmorliv i IS-kalifat](#)

Raportet e CTED: Vlerësimi i mangësive në zbatimin e dispozitave kyçe të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit kundër financimit të terrorizmit

Në vitin 2021 dhe 2022, Drejtoria Ekzekutive e Komitetit Kundër Terrorizmit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (CTED) kreu një vlerësim tematik të mangësive në zbatimin e dispozitave kyçe të financimit të terrorizmit (CFT) të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit dhe publikoi dy raporte duke diskutuar gjetjet e saj. Ky vlerësim bazohet në informacionin e mbledhur gjatë vizitave në 13 Shtete Anëtare me qëllim identifikimin e fushave prioritare në të cilat shtetet do të përfitonin nga përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve, nga asistenca teknike të synuar dhe nga ekspertiza e specializuar.

Sipas raporteve, një nga mangësitë e identifikuar ka të bëjë me mosnjohjen sa duhet të rreziqeve të financimit të terrorizmit. Në këtë drejtim, këto raporte konstatojnë se disa Shtete Anëtare nuk e kanë kryer ende vlerësimin e rreziqeve në shkallë kombëtare për financimin e terrorizmit ose se vlerësimet e tyre kombëtare të rrezikut (NRA) nuk janë gjithëpërfshirëse sa duhet. Raportet theksojnë më tej se disa NRA nuk mbështeten nga të dhëna statistikore të besueshme dhe se shtetet nuk i përditësojnë rregullisht NRA-të e tyre. Rekomandimet për adresimin e mangësive të identifikuar përfshijnë, ndër të tjera, dhënien e mbështetjes për kryerjen e vlerësimeve rajonale të rrezikut të financimit të terrorizmit dhe përdorimin e një qasjeje me shumë aktorë gjatë analizimit të rreziqeve ekzistuese dhe rreziqeve të reja të financimit të terrorizmit.

Raportet identifikojnë boshllëqe në mënyrën se si e parashikojnë financimin e terrorizmit si një vepër penale. Disa nga mangësitë në këtë fushë përfshijnë mosparashikimin e qartë të financimit të udhëtimeve terroriste të huaja si vepër penale, përkufizimin shumë të ngushtë të termit "fonde", kriterin që financimi i terroristëve individualë duhet të lidhet me një akt të caktuar terrorist, sanksionet disproporcionale, etj. Megjithatë, këto mangësi "po adresohen në mënyrë progresive dhe aktualisht janë kryesisht teknike për nga natyra, duke kërkuar rregullime të kufizuara në legjislacion ose thjesht sqarime në praktikën gjyqësore".

Raportet e CTED shpjegojnë më tej se "hetimi dhe ndjekja penale e financimit të terrorizmit mbetet sfiduese në shumë nivele, nga ekspertiza teknike deri të bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi mes agjencive të ndryshme. Në këtë drejtim, raportet theksojnë se numri i ndjekjeve të suksesshme është në përgjithësi i ulët. Kryerja e hetimeve financiare paralele në rastet e terrorizmit nuk është e detyrueshme dhe shumë shtete zgjedhin të mos hetojnë dhe të mos i ndjekin penalisht këto akuza, veçanërisht kur ato nuk kanë një lidhje të dukshme me një akt të caktuar terrorist. Në përgjithësi, shtetet nuk kryejnë hetime financiare për luftëtarët e huaj terroristë. Raportet theksojnë më tej se njësitë e inteligjencës financiare (FIU) nuk janë të përfshira në platformat ekzistuese mes agjencive që përdoren për shkëmbimin e informacionit mbi kërcënimet dhe hetimet terroriste, dhe se bashkëpunimi mes agjencive ka mangësi. Si rezultat, "shumë pak raporte të lidhura me financimin e terrorizmit të dorëzuara nga NjIF tek autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit shkaktajnë veprime të mëtejshme, duke përfshirë edhe hetimet penale". Një sfidë tjetër e zbuluar në këto raporte është edhe mungesa e masave mbrojtëse për të lejuar që inteligjenca financiare të shndërrohet në mënyrë efektive në prova që mund të përdoren për të siguruar dënime për financimin e terrorizmit. Dhe e fundit, Njësitë e Inteligjencës Financiare (FIU) dhe autoritetet e tjera përkatëse në përgjithësi nuk kanë kapacitete teknike dhe ekspertizë mjaftueshme për të zbuluar, për të goditur dhe për të hetuar rastet e financimit të terrorizmit. Për të adresuar këto sfida, raportet rekomandojnë ofrimin e trajnimeve për hetimet dhe ndjekjet penale të financimit të terrorizmit për organet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët; forcimin e kapaciteteve të të gjitha autoriteteve përkatëse të përfshira në luftën kundër financimit të terrorizmit; lehtësimin e shkëmbimit të përvojave me shtetet e tjera anëtare për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër financimit të terrorizmit; dhe sigurimin e

softuereve dhe mjeteve të tjera përkatëse për analizën e transaksioneve financiare.

Në lidhje me mekanizmin e ngrirjes së aseteve, raportet vërejnë se kuadri legjislativ për zbatimin e masave të ngrirjes së aseteve në përputhje me rezolutën 1373 (2001) në disa shtete ose nuk ekziston ose nuk shfrytëzohet sa duhet në nivel operacional. Në shtete të tjera, vlerësimi zbuloi mangësi në zbatimin e masave të ngrirjes së aseteve në mënyrë efektive dhe pa vonesë; në rishikimin e shpalljeve të subjekteve të caktuara në listat e sanksioneve në shkallë kombëtare dhe në heqjen e tyre nga lista; si dhe në formulimin dhe komunikimin e njoftimeve për shpalljet mbi listat e sanksioneve. Ngrirja e aseteve virtuale është gjithashtu një fushë problematike sepse shteteve në përgjithësi u mungojnë njohuritë dhe përvoja praktike për të zbatuar masa të tilla. Raportet rekomandojnë që shtetet të zhvillojnë manuale për zbatimin e masave të ngrirjes së aseteve, si dhe të shkëmbejnë përvoja dhe praktika të mira mes tyre.

Raportet identifikojnë disa boshllëqe në parandalimin e abuzimit për qëllime terroriste të shërbimeve të transferimit të parave, rrjeteve financiare informale dhe korrierëve të parave. Vihet re se disa shtete nuk kryejnë vlerësime të rrezikut në lidhje me metodat e reja të pagesës dhe instrumentet financiare dhe se atyre u mungojnë kapacitetet operacionale për të zbuluar dhe për të parandaluar në mënyrë efektive përdorimin e sistemeve të ngjashme me havalën për qëllime të financimit të terrorizmit. Probleme të tjera përfshijnë mangësitë në monitorimin e zbatimit të ligjit nga operatorët e parave të lëvizshme, në masat e pamjaftueshme të kontrollit kufitar dhe doganor dhe në bashkëpunimin e pamjaftueshëm dypalësh dhe ndërkombëtar. Në lidhje me këtë të fundit, raportet nënvizojnë se "shteteve u mungon bashkëpunimi dhe koordinimi ndërkufitar për të goditur dhe për të çmontuar rrjetet e përfshira si korrierët e parave dhe tregtinë e paligjshme përtej kufijve që financojnë terrorizmin" dhe se shtetet duhet të rrisin shkëmbimet e informacionit me homologët e huaj, duke pasur parasysh natyrën ndërkufitare të shumicës së transfertave informale të parave.

Raportet e CTED paralajmërojnë më tej për boshllëqet në adresimin e rreziqeve të financimit të terrorizmit që lidhen me asetet virtuale dhe me platformat e financimit të njohura si *crowdfunding*. Këto përfshijnë, ndër të tjera, korniza rregullatore joadekuate për asetet virtuale, mospërfshirjen në rregullimin e LPP/LFT të platformave e *crowdfunding*, udhëzimet e pamjaftueshme për subjektet raportuese dhe mungesën e përvojës/kapacitetit për hetimin e terroristëve lidhur me përdorimin e aseteve virtuale. Ndihamë e rekomanduam përfshin ofrimin e mbështetjes në hartimin dhe miratimin e kuadrit rregullator AML-CFT në lidhje me asetet virtuale dhe lehtësimin e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në këtë drejtim, si dhe ofrimin e programeve dhe mjeteve të trajnimit për të hetuar rastet e financimit të terrorizmit që përfshijnë kriptovalutat dhe teknologjitë e reja të pagesave.

Të tjera mangësi të identifikuar përfshijnë moskryerjen e vlerësimit të rrezikut të abuzimit të sektorit të organizatave jofitimprurëse (OJF) për qëllime të financimit të terrorizmit dhe mosngritjen e mekanizmave për monitorimin ose mbikëqyrjen e synuar me bazë riskun të sektorit të OJF-ve. Në disa shtete, janë zbuluar edhe boshllëqe në kuadrin rregullator të OJF-ve dhe në masat për bërjen transparente të donacioneve.

Dhe e fundit, raportet konstatojnë disa boshllëqe në analizimin dhe zbulimin e lidhjeve ndërmjet krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit. Në këtë aspekt vihet re se shumica e shteteve nuk kanë një kornizë ligjore, praktika ose burime për t'i hetuar në mënyrë proaktive këto lidhje dhe nëse të ardhurat nga rastet përkatëse të krimit të organizuar kanë pasur për qëllim ose janë përdorur për financimin e terrorizmit. Për të adresuar mangësitë e identifikuar, raportet rekomandojnë ofrimin e trajnimeve dhe formave të tjera të ndihmës "për të rritur kapacitetin e autoriteteve përkatëse për të zbuluar dhe për të parandaluar lidhjet midis terrorizmit, financimit të tij dhe krimit të organizuar".

Burimi: [CTED Vlerësimi përmbledhës tematik i boshllëqeve në zbatimin e dispozitave kyçe të rezolutave të Këshillit të Sigurimit kundër financimit të terrorizmit](#)